



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup



Здружение на новинарите на Македонија



UDHËZUES PËR SIGURI TË GAZETARËVE GJATË NGJARJEVE ME RREZIK TË LARTË

AUTORË:

Ivan Breshkovski, avokat

Toni Angellovski, ndihmës ministër i Punëve të Brendshme

Spasenka Andonova, prokurore publike

IMPRESUM

Për botuesin:

Misioni i OSBE-së në Shkup

Autorë:

Ivan Breshkovski, Toni Angelovski, Spasenska Andonova

Koordinim:

Ministria e punëve të brendshme (MPB)

Shoqata e gazetarëve (SHGM)

Përkthimi:

Eniena Aeti

Lekturimi:

Lulzim Ademi

Përgatitja kompjuterike dhe botimi:

Vinsent Grafika, Shkup

Tirazhi:

80 kopje

Ky publikim është falas

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

316.774-051:342.732(497.7)(035)

316.774-051:351.751(497.7)(035)

BRESHKOVSKI, Ivan

Udhëzues për siguri të gazetarëve gjatë ngjarjeve me rrezik të lartë / autorë Ivan Breshkovski, Toni Angelovski, Spasenska Andonova. - Shkup : OSCE, 2018. - 40 стр. ; 24 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4788-33-1

1. Angelovski, Toni [автор] 2. Andonova, Spasenska [автор]

а) Новинари - Слобода на изразување - Македонија - Прирачници б)

Новинари - Безбедност - Македонија - Прирачници

COBISS.MK-ID 108731658



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup. Misioni i përmbahet vendimit PC. DEC/81 të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së.

PËRMBAJTJA:

PJESA – I – Autor: Ivan Breshkovski, Avokat.....5

Hyrje dhe qëllimi i udhëzuesit.....	6
Sulmet mbi gazetarët, fotoreporterët dhe punonjësit e mediave dhe politika e mos-ndëshkimit.....	7
Regjistri i rasteve të shkeljes së të drejtave të gazetarëve në kuadër të SHGM-së dhe praktika të veprimit për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve.....	9
Platforma rajonale e Ballkanit Perëndimor për përfaqësimin e ë mediave dhe mbrojtjen e gazetarëve	11
Praktika dhe rekomandime nga organizata ndërkombëtare politike dhe qytetare për sigurinë e gazetarëve:.....	12
Këshilli i Evropës dhe Rekomandimi CM/Rec (2016)4.....	13
Rekomandime për siguri të gazetarëve nga organizata evropiane dhe ndërkombëtare të gazetarëve dhe të mediave.....	17

PJESA – II – Autor: Spasenka Andonova, Prokurore Publike.....25

Prokuroria publike dhe mediat.....	26
Bashkëpunimi mes MPB-së, PP-së dhe mediave.....	28
Roli i PP-së, MPB-së dhe gazetarëve gjatë kohës së kontrollit.....	30

**PJESA – III – Autor: Ivan Breshkovski, Avokat,
Toni Angellovski, MPB.....33**

Në çfarë mënyre të veprojnë gazetarët, fotoreporterët dhe punonjësit
e mediave në rast të rrezikut.....34

Masa aktive dhe rekomandime për siguri të gazetarëve, fotoreporterëve dhe
punonjësve të mediave gjatë raportimit nga ngjarje me rrezik të lartë.....35

PJESA – IV – Informacione plotësuese.....39

Burime plotësuese për siguri të gazetarëve, fotoreporterëve dhe
punonjësve të mediave.....40

Shkurtesat.....40

PJESA I

AUTOR:
IVAN BRESHKOVSKI, AVOKAT

HYRJE DHE QËLLIMI I UDHËZUESIT

Ky Udhëzues është pjesë e aktiviteteve të cilat që prej fillimit të vitit 2018 bashkërisht i kanë filluar dhe i drejtojnë Shoqata e Gazetarëve (SHGM), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Misioni i OSBE-së në Shkup për shkak të sulmeve të shpeshtuara fizike dhe verbale në të cilat janë ekspozuar gazetarët, fotoreporterët dhe punonjësit e mediave gjatë kryerjes së detyrave të tyre profesionale.

SHGM-ja dhe MPB-ja bashkëpunojnë për ngritjen e një mekanizmi institucional për parandalim dhe ndëshkim të dhunës mbi gazetarët me anë të regjistrimit të këtyre rasteve por edhe me anë të ngritjes së vetëdijes së institucioneve kompetente dhe opinionit më të gjerë. Ky udhëzues ka për qëllim të identifikojë rreziqet dhe të shmang sulmet dhe shtypjet me të cilat përballen gazetarët veçanërisht gjatë raportimit nga ngjarje me rrezik të lartë. Përveç kësaj, udhëzuesi shërben për të sqaruar procedurat dhe kompetencat ligjore të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) por edhe të Prokurorisë Publike (PP) për të siguruar mbrojtje më të madhe për gazetarët.

Gjithashtu, udhëzuesi ofron praktika dhe përvoja të parandalimit të sulmeve dhe shtypjeve ndaj gazetarëve të hartuar nga SHGM-ja dhe organizata tjera ndërkombëtare qytetare dhe politike.

Gjatë përpilimit të këtij udhëzuesi, paraprakisht u organizuan gjashtë punëtori në temën e sigurisë së gazetarëve gjatë raportimit nga ngjarjet me rrezik të lartë, lirisë së shprehjes dhe përmirësimit të komunikimit të gazetarëve dhe policisë. Punëtoritë që u realizuan në gjysmën e dytë të vitit 2018 në shumë qytete të vendit, u organizuan nga Misioni i OSBE-së në Shkup në bashkëpunim me SHGM-në dhe MPB-në. Në këto punëtori kanë marrë pjesë gazetarë, fotoreporterë si dhe pjesëtarë të MPB-së, ku u shkëmbyen përvojat dhe u identifikuan pikat në të cilat bashkëpunimi duhet të avancohet.

Këto aktivitete ndërlidhen me Memorandumin e Bashkëpunimit të nënshkruar paraprakisht mes SHGM-së dhe MPB-së më 29 dhjetor 2017, që ka pasur për qëllim rritjen e sigurisë së gazetarëve në kushte kur sulmet mbi gazetarët gjatë viteve të fundit ishin shpeshtuar, ndërsa incidentet mbeteshin të pazgjidhur nga ana e institucioneve kompetente. Për herë të parë pas shumë viteve vendoset baza për bashkëpunim mes shoqatës artizane gazetareske dhe një institucion si MPB-ja.

Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme nga qershori i vitit 2017 e tutje janë regjistruar 12 sulme ndaj gazetarëve dhe të gjitha dymbëdhjetë rastet janë zgjidhur nga MPB. Ndriçimi i rasteve dhe hapja për bashkëpunim nga ana e Ministrisë së Brendshme është parakusht themelor për të trajtuar këtë dukuri.

Gjithashtu, më 28 mars 2018, Misioni i OSBE-së në Shkup dhe SHGM-ja kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me të cilin është parashikuar organizimi i trajnimeve dhe ngjarjeve që kanë për qëllim përmirësimin e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve të mediave por edhe të përmirësohet cilësia e raportimit të tyre.

Ky udhëzues duhet t'ju ndihmojë gazetarëve që detyrat e tyre profesionale, të informimit me kohë dhe të saktë të qytetarëve, t'i kryejnë në kushte të sigurta dhe të realizojnë qëllimin e tyre, gjegjësisht mbrojtjen e interesit publik. Gjithashtu, në udhëzues do të jepet një pasqyrë e rregulloreve ligjore që përfshin punën e gazetarëve gjatë raportimit nga ngjarjet me rrezik të lartë.

SULMET MBI GAZETARËT, FOTOREPORTERËT DHE PUNONJËSIT E MEDIATEVE DHE POLITIKA E MOS-NDËSHKIMIT

Vendi ynë, gjatë dhjetë viteve të fundit, ka shënuar një rënie të vazhdueshme në të gjitha raportet e besueshme që merren me analizën e shkallës së lirisë së të shprehurit dhe lirisë së mediave. Për shembull, sipas Indeksit të Lirisë së Shtypit¹ nga Gazetarë pa Kufij, vendi ynë në vitin 2007 ka qenë në një renditje të lartë të 36-të në botë ndërsa në vitin 2014 shënoi rënie në vendin e 123-të nga gjithsej 180 vende. Raportet nga organizatat tjera të besueshme gjatë viteve të fundit gjithashtu ishin mjaft kritik për lirinë e të shprehurit.

Raporti i Fridom Haus (Freedom House) për vitin 2018 i citon edhe pohimet e SHGM-së, në të cilat theksohet: *“21 gazetarë janë sulmuar nga fillimi i vitit 2016 përfshi edhe muajin maj të vitit 2017. Në disa raste të caktuara, gazetarët janë sulmuar gjatë zbatimit të detyrave të tyre, siç është rasti i marsit 2017, kur persona të maskuar kanë sulmuar dy gazetarë që kanë raportuar nga një mbledhje e VMRO-DPMNE-së”*. Përveç kësaj, në pjesën „D4“ në të cilën parashtrrohet pyetja *„A janë të lirë individët të shprehin qëndrimet e tyre personale për tema politike dhe tema tjera të ndjeshme pa frikë nga mbikëqyrja ose hakmarrja“* theksohet që indeksi i caktimit të pikëve është përmirësuar nga shkakut që qeveria e re ka ndërmarrë hapa të caktuara për reforma të shërbimeve të sigurisë dhe për këtë arsye, frika për t'u shprehur publikisht është zvogëluar.²

¹ Indeksi i Lirisë së Shtypit nga Gazetarë pa Kufij <https://rsf.org/en/ranking> qasur më 10.08.2018

² Raporti i Fridom Hausit (Freedom House) për vitin 2018 <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2018/macedonia> qasur më 10.08.2018

Problemi me sulmet mbi gazetarët është theksuar edhe në Raportin për të Drejtat e Njeriut³ të vitit 2017 i publikuar nga Sekretariati Shtetëror i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (Departamenti i Shtetit). Në këtë raport janë përshkruar disa raste të kërcënimit dhe frikësimit të gazetarëve, si dhe është theksuar nëse është marrë ndonjë veprim dhe çfarë është ndërmarrë nga ana e organeve kompetente. Ky raport thekson që sipas organizatave të mediave, autoritetet nuk kanë vepruar në mënyrë të drejtë dhe asnjë prej kriminelëve nuk ka qenë i ndëshkuar në mënyrë përkatëse për sulmet mbi gazetarët. Më tutje në raport sqarohet që pushteti paraprak ka ushtruar shtypje ndaj gazetarëve që ka rezultuar me auto-censurë dhe njëkohësisht, gazetarët kanë raportuar përzierje nga ana e përfaqësuesve të pushtetit në punën e tyre, veçanërisht gjatë raportimit të temave të ndjeshme. Raporti gjithashtu thekson që edhe mediat private janë ankuar që kanë pranuar porosi dhe urdhra nga funksionarë të lartë për atë se në cilën mënyrë dhe çfarë të raportojnë mbi tema lidhur me çështje politike.

Në Raportin e Përparimit të Vendit për vitin 2018 i publikuar nga Komisioni Evropian⁴ në pjesën e lirisë së të shprehurit me një titull „Frikësimi i gazetarëve“, theksohet: “Me përmirësimin e klimës politike vërehet ulje të shtypjes mbi gazetarët. Në dhjetor të vitit 2017, Qeveria ka nënshkruar marrëveshje me Shoqatën e Gazetarëve për zbatim të hetimeve vijuese për sulmet mbi gazetarët. Megjithatë, denoncimi i sulmeve mbi gazetarët mbetet në nivel të papërshtatshëm dhe janë filluar vetëm një numër i vogël i hetimeve. Me rëndësi thelbësore është që organet të tregojnë zero tolerancë ndaj të gjitha incidenteve të keqpërdorimit fizik dhe verbal ose kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe që ata duhet në mënyrë efektive të vëzhgohen nga ana e policisë dhe Prokurorisë Publike. Ka pasur 21 raste të reja të denoncuar të frikësimit të gazetarëve dhe 13 procedura gjyqësore në të cilat janë përfshirë gazetarë. Disa prej gazetarëve ishin në mesin e të lënduarve gjatë incidenteve të dhunshëm në Kuvend më 27 prill”, shkruan në raportin.

Për sulmet mbi gazetarët gjatë viteve të fundit ka pasur reagime edhe nga ana e organizatave ndërkombëtare, siç janë Përfaqësuesi i Lartë i OSBE-së për Liri të Mediave, Raportuesi Special për Promovim dhe Mbrojtje të së Drejtës së Lirisë së të Menduarit dhe të Shprehurit pranë Kombeve të Bashkuara (OKB), Federata Ndërkombëtare dhe Evropiane e Gazetarëve (FNG dhe

³ Raporti për të Drejtat e Njeriut publikuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA-ve <https://www.state.gov/documents/organization/277435.pdf> qasur më 11.08.2018

⁴ Raporti për Përparimin e Vendit për vitin 2018, Komisioni Evropian <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/-20180417the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf> qasur më 10.08.2018

FEG), Organizata e Mediave të Evropës Juglindore, dhe tjera. Të gjitha këto raporte dhe apele që vinin nga organizata të besueshme për sulmet mbi gazetarët kanë pasqyruar alarmet për shkallën e ultë të sigurisë.

Nevoja për mjedis të garantuar dhe të sigurt për punë të gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve të mediave si dhe ndërprerja e politikës së mosndëshkimit në raste kur shkelen të drejtat e tyre janë dy parakushtet themelore për liri të mediave dhe të gazetarëve. Për shkak të shkeljes së këtyre dy parimeve, si dhe për shkak të kushteve tjera që janë të ndërlidhur me statusin e cenuar social të gazetarëve, ndikimi i qendrave të fuqisë mbi pronarët e mediave përsi edhe transmetuesin publik, në të kaluarën kanë kontribuar që shteti të renditet si një prej shteteve më të ulëta në indekset botërore për lirinë e të folurit dhe pavarësi të mediave.

REGJISTRI I RASTEVE TË SHKELJES SË TË DREJTAVE TË GAZETARËVE NË KUADËR TË SHGM-SË DHE PRAKTIKAT E VEPRIMIT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË GAZETARËVE

SHGM-ja, në kuadër të punës së saj, mban një regjistër të rasteve të shkeljes së të drejtave të gazetarëve dhe mënyrat në të cilat kanë vepruar institucionet. Ky regjistër është i qasshëm për publikun dhe shpallet në internet faqen e SHGM⁵ -së dhe i njëjti përditësohet disa herë në vit.

Ky regjistër shërben për të regjistruar të gjitha sulmet mbi gazetarët që janë të denoncuar në Shoqatë ose që për të njëjtët ka pasur publikime në media, si dhe shërben për të prezantuar me anë të raporteve vjetore të SHGM-së, në çfarë mënyre kanë vepruar institucionet kompetente në pjesën e hetimit dhe përndjekjes si dhe gjatë procedurave gjyqësore. Regjistri, në versionin e shkurtë të publikuar, përmban datën në të cilin ka ndodhur incidenti, lloji i incidentit, vendi i ndodhjes, përshkrimi i shkurtë i incidentit, emri dhe mbiemri i gazetarit, fotoreporterit ose punonjësit të medias dhe media në të cilin është angazhuar, emri i kryerësit (nëse njihet), pastaj, nëse incidenti është denoncuar në MPB dhe një koment që përshkruan detaje të incidentit ose statusin mbi incidentin.

⁵ Regjistri i Sulmeve i SHGM-së www.znm.org.mk/wp-content/uploads/06/2018/Случаи-на-повреда-на-правата-на-новинарите-Јуни2018-.docx qasur më 11.08.2018

Pavarësisht nga niveli i seriozitetit të incidentit, SHGM-ja ka praktikë të veprorë dhe të ofrojë ndihmë për gjitha rastet që janë të denoncuar në Zyrën ekzekutive. Nga bisedat me të punësuarit në zyrën e SHGM-së, kjo praktikë fillimisht nënkupton kontroll të fakteve rreth incidentit dhe kjo shpesh zhvillohet me bisedë ose shkëmbim të komunikimit me shkrim me gazetarin që ka qenë objekt i sulmit si dhe me dëshmitarë okularë, nëse eventualisht ka pasur të pranishëm. Përveç kësaj, nëse sulmi ka ndodhur në qytet tjetër, kontaktohen edhe koordinаторët rajonal të SHGM-së për të fituar një kontekst plotësues. Varësisht nga specifikat e rastit, mund të kontaktohet edhe ndonjë përfaqësues i MPB-së, zakonisht zëdhënësi ose komisar i stacionit si dhe përfaqësues të PP-së, dhe të Misionit të OSBE-së në Shkup. Në raste kur ka shkelje të dukshme të të drejtave të gazetarëve dhe këto shkelje janë të mbështetura me regjistrime të shpallur në media, reagimi publik nga ana e SHGM-së zakonisht është i shpejtë dhe në formë të një deklaratë për publikun me dënim dhe me kërkim të përgjegjësisë, por ka pasur edhe raste dhe shembuj kur janë organizuar edhe konferenca për shtyp por edhe protesta publike. Shpeshherë, alarmohen edhe organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve që gjithashtu mund të kenë reagime publike dhe/ose komunikime me autoritetet kompetente prej të cilave kërkohet hetim i shpejtë.

SHGM-ja, përveç reagimeve publike dhe vëzhgim të rasteve që janë në procedurë para institucioneve, shpesh ofron edhe ndihmë juridike falas kur bëhet fjalë për lëndimin e ndonjërit prej tyre. Përveç kësaj, në raste që administrohen me detyrë publike nga ana e Prokurorisë Themelore Publike, SHGM-ja shpeshherë parashtron kërkesë për nisje të procedurave penale në emër të gazetarëve të dëmtuar. Gjithashtu, në raste kur ka pasur dyshim që hetimi i MPB-së nuk është në përputhje me ligjin ose ka dëshmi që të drejtat e gazetarëve kanë qenë të shkelura nga ana e pjesëtarëve të MPB-së, SHGM-ja drejtohet me parashtrësë te Departamenti për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale që është mekanizëm kontrollues i Ministrisë mbi punën e policisë. Për ato raste që janë në procedurë gjyqësore, pa dallim nëse procedurat janë duke u zbatuar nga gjykata civile ose penale, SHGM-ja disa herë në vit dorëzon kërkesë në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik për të bërë kontroll se në çfarë faze janë lëndët. Në rast se ka aktvendim gjyqësor dhe pastaj janë shfrytëzuar të gjitha mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike para organeve gjyqësore, si dhe nëse janë plotësuar kushtet për nisje të procedurave para Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg, SHGM-ja ka ndihmuar të parashtrohen aplikime për shkelje të dispozitave të Konventës Evropiane për të Drejta e Njeriut pranë GJEDNJ-së. Në këtë drejtim, gjashtë gazetarë që kanë qenë të mbështetur të kërkojnë drejtësinë për incidentet e 24 dhjetorit 2012, në mars të vitit 2017 kanë marrë aktgjykimin për rastin „Selmani dhe të

tjerët kundër shtetit“, që është aktgjykimi i parë në të cilin konstatohet shkelje e nenit 10 të Konventës, gjegjësisht shkelje e të drejtës së lirisë së të shprehurit si dhe të nenit 6 që ka të bëjë me procedurën e drejt të gjykitimit.

PLATFORMA RAJONALE E BALLKANIT PERËNDIMOR PËR PËRFAQËSIM TË MEDIAVE DHE MBROJTJE TË GAZETARËVE

Kjo platformë paraqet një sistem të përbashkët të mbrojtjes së gazetarëve kur siguria e tyre është e cenuar në bazë të protokolleve të përcaktuar nga gjashtë shoqata kombëtare të gazetarëve, siç janë shoqata nga vendi, nga Beogradi, Prishtina, Podgorica dhe Sarajeva. Kjo platformë, që përfaqëson mbi 8000 gazetarë të Ballkanit Perëndimor është në kuadër të projektit trevjeçar i filluar në vitin 2016 ndërsa i financuar nga ana e Bashkimit Evropian dhe kjo platformë promovon standardet e BE-së për liri të mediave dhe pluralizmin e medias.

Qëllimi specifik i këtij projekti është krijimi i një on-line platforme „Sistem për Paralajmërim dhe Parandalim të Hershëm“ si mekanizëm për veprim të përbashkët për zbatimin e standardeve të BE-së në fushën e medias dhe parandalimit të keqpërdorimit, me anë të ngritjes së kapaciteteve, rrjetëzimit dhe shkëmbim të njohurive të gjashtë shoqatave rajonale të gazetarëve.

Për momentin, nëse merren parasysh të gjitha sulmet në Ballkanin Perëndimor gjatë 4 viteve të fundit, sipas kësaj platforme⁶ janë gjithsej 468 sulme, dhe ajo që është e përbashkët në të gjitha vendet është niveli i ultë i zbardhjes së këtyre incidenteve nga ana e autoriteteve, veçanërisht kur sulmuesit janë pjesëtarë të ministrive për punë të brendshme ose janë përfaqësues të pushtetit ekzekutiv ose partive politike.

Sistemi i paralajmërimit dhe parandalimit të hershëm është një shembull i mirë në rajon kur bëhet fjalë për bashkëpunim të përbashkët të shoqatave artizane në drejtim të uljes së sulmeve ndaj gazetarëve por edhe uljes së ndikimit të politikës së mosndëshkimit në vendet anëtare. Këtë mekanizëm e përdorin gjashtë shoqata, mes të cilave edhe SHGM-ja si partnere e projektit nga vendi, ku me anë të një protokollit konkret, shoqatat në mënyrë të bashkuar veprojnë për parandalimin e sulmeve fizike dhe presioneve tjera mbi gazetarët, dhe në rast të incidentit,

⁶ Internet faqja e Platformës Rajonale për Përfaqësim të Medieve dhe Mbrojtje të Gazetarëve e Ballkanit Perëndimor <http://safejournalists.net/> qasur më 05.08.2018

ata bashkërisht reagojnë në mënyrë publike dhe institucionale me aktivitete të drejtuar autoriteteve të vendit në të cilin ka ndodhur sulmi. Protokollin i përmban rekomandimet për mbrojtje të gazetarëve të Këshillit të Evropës dhe UNESCO-së, ndërsa sulmet ndaj gazetarëve i ndan në disa kategori, sipas mënyrës vijuese: sulme fizike, kërcënim jete për gazetarin ose anëtar të afërt të familjes, kërcënim i mbylljes së medias nga ana e institucionit publik ose kërcënime publike për dhunë ndaj gazetarit ose grupit të gazetarëve. Përveç kësaj, ka edhe dy kategori më serioze të shkeljes së të drejtave të gazetarëve, e ato janë paraburgim ose privim i paligjshëm nga liria, ndërsa kategoria e fundit është vrasje.

Kjo platformë ju ndihmon gazetarëve në më tepër aspekte edhe atë me aktualizimin e problemit në opinion dhe këmbënguljen për zgjidhjen urgjente nga ana e organeve kompetente por edhe dhënien e ndihmës juridike falas në raste kur ata janë të paditur.

Për të gjitha aktivitetet, si dhe për secilin rast në veçanti, mbahet një dosje e veçantë në platformën on-line <http://safejournalists.net/>. Me rëndësi është të theksohet që secili gazetar, fotoreporter ose punonjës i mediave ka mundësi që me anë të një formulari on-line vetë personalisht të denoncojë sulm ose presion në platformë dhe pastaj ky denoncim të shqyrtohet në përputhje me protokollin.

Përveç kësaj, në këtë platformë, një herë në vit publikohen edhe raporte vjetore nga secila shoqatë e gazetarëve me indikatorë të lirisë së të shprehurit dhe pavarësisë së mediave. Këto raporte përfshijnë tri pjesë të rëndësishme për sektorin, pjesa e parë është rrethimi ligjvënës dhe praktika gjyqësore, pastaj tendencat e dhunës ndaj gazetarëve dhe pjesa e tretë i përfshin të drejtat e punëtorëve dhe ato sociale të gazetarëve.

PRAKTIKA DHE REKOMANDIME NGA ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE POLITIKE DHE QYTETARE PËR SIGURINË E GAZETARËVE:

Në kuadër të Këshillit të Evropës, nga dhjetori i vitit 2014, funksionon Platforma⁷ për Promovim të Mbrojtjes së Gazetarisë dhe Sigurisë së Gazetarëve. Kjo platformë paraqet një hapësirë

⁷ Platforma për Promovim të Mbrojtjes së Gazetarisë dhe Sigurisë së Gazetarëve <https://www.coe.int/en/web/media-freedom/the-platform> qasur më 12 gusht 2018

publike në të cilën regjistrohen, përpunohen dhe publikohen incidente dhe rreziqe të lidhur me lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve në vendet anëtare të Këshillit të Evropës që janë të garantuar me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Qëllimi i kësaj platforme është të mbrojtë gazetarët dhe të adresojë problemet tek institucionet relevante në kuadër të vendeve anëtare.

Në këtë platformë publikohen edhe paralajmërimet kur ka presion nga ana e institucioneve ndaj mediave si persona juridikë por edhe kur ka rregullore në vende anëtare, ndërsa ka të bëjë me sektorin e medias dhe për këtë ka dyshime që mund të jetë kufizuese dhe të kufizojë të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të krijojë auto-censurë.

Përveç paralajmërimeve, në këtë platformë publikohen edhe përgjigjet nga ana e institucioneve kompetente të vendeve anëtare.

KËSHILLI I EVROPËS DHE REKOMANDIMI CM/REC(2016)4

Në prill të vitit 2016, Komiteti i Ministrave pranë Këshillit të Evropës ka miratuar Rekomandimin CM/Rec(2016)4⁸ për Mbrojtjen e Gazetarisë, Sigurisë së Gazetarëve dhe Punonjësve të Mediave, duke dënuar nivelin alarmues dhe të papranueshëm të kërcënimeve të drejtuar gazetarëve dhe punonjësve të mediave në Evropë dhe duke siguruar drejtime të veçanta për vendet anëtare të Këshillit të Evropës që të reagojnë në fushën e parandalimit, mbrojtjes, persekutimit, promovimit të së drejtës për informim të lirë dhe edukim dhe ngritje të vetëdijes së qytetarëve për këto çështje.

Vrasjet e gazetarëve në shtetet e Këshillit të Evropës, por edhe numri i rritur i sulmeve fizike dhe kërcënimeve ka sjellë deri te nevoja urgjente për miratim të rekomandimit të përmendur më lartë me qëllim që të detyrojë shtetet anëtare të ndërmarrin masa që do të garantojnë siguri të gazetarëve.

⁸ Internet faqja e Këshillit të Evropës, Rekomandimi CM/Rec(4)(2016) https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016806415d#9_ftn1 qasur më 09.08.2018

Rekomandimi CM/Rec(2016)4 është dokument obligues për shtetin që do të thotë se përmbajtja e rekomandimit duhet të zbatohet nga pushteti ekzekutiv, ligjvënës dhe gjyqësor në shtet, gjegjësisht të gjitha udhëzimet përbërëse të zbatohen në veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore kur bëhet fjalë për sigurinë e gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve të mediave. Këto udhëzime janë gjithashtu të dizajnuar për të përballuar sfidat e shumta për sigurim të mbrojtjes efikase të gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve dhe subjekteve tjerë të medias, që kërkon strategji koherente dhe plotësuese nga ana e vendeve anëtare.

Udhëzime thelbësore nga Rekomandimi CM/Rec(2016)4 në pjesën e PARANDALIMIT

- » Vendet anëtare të sigurojnë kushte për media të pavarura, të mbrojnë pluralizmin dhe të sigurojnë shërbim të qëndrueshëm publik
- » Të sigurojnë kornizë ligjore për mbrojtjen e burimeve gazetareske dhe informatorëve
- » Mbrojtje të gazetarëve nga dhuna në bazë të gjinisë, diskriminimi dhe promovimi i barazisë gjinore
- » Revizion të vazhdueshëm të këtyre masave nga trupat qeveritare dhe joqeveritare, veçanërisht shoqatat gazetareske dhe sindikatat
- » Kontroll të fuqishëm mbi agjencitë shtetërore për monitorim të komunikimeve, garanci procedurale kundër keqpërdorimit të mekanizmave kontrolluese

Udhëzime thelbësore nga Rekomandimi në pjesën e MBROJTJES

- » Mekanizma efektive për mbrojtje, të mbështetur nga organet e ndjekjes që do të mundësojnë mbrojtje të gazetarëve.
- » Mbrojtje policore, veçanërisht kur atë e kërkojnë gazetarë ose subjekte tjera të medias, ose evakuim vullnetar në vend të sigurt.
- » Shtetet anëtare duhet të nxisin themelimin dhe mbështetjen e mekanizmave për paralajmërim të hershëm dhe reagim të shpejtë, siç janë linja telefonike, platforma on-line ose pika kontaktuese 24 orëshe për raste urgjente, nga ana e organizatave të mediave ose shoqërisë qytetare, për të siguruar që gazetarët dhe subjektet tjera të medias të kenë qasje të drejtpërdrejtë në masat mbrojtëse në raste kur janë të kërcënuar.

- » Në raste të privimit nga liria të gazetarëve ose subjekteve tjera të medias nga ana e policisë ose nëpunësve tjerë për zbatimin e ligjit, duhet të respektohen garanci të caktuara procedurale, me qëllim të parandalimit të arrestimit të paligjshëm ose keqtrajtimit.
- » Nga vendet anëtare kërkohet që të zhvillohen protokolle dhe programe për trajnim për gjitha organet shtetërore që janë përgjegjës për plotësimin e obligimeve shtetërore në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve dhe subjekteve tjera të medias (gjykatës, prokurorë, nëpunës policor, personel ushtarak, etj.).
- » Shtetet anëtare duhet të sigurojnë një ambient të volitshëm për zbatimin përkatës të ligjeve dhe sanksioneve, dhe nuk guxojnë të jenë diskriminues ose arbitrar kundër gazetarëve dhe subjekteve tjera të medias (frikësim të gazetarëve me anë të dënimeve të larta).
- » Shtetet anëtare duhet të marrin parasysh natyrën specifike dhe vlerën demokratike që me vete bartin gazetarët dhe subjektet tjera të medias në kontekste të caktuara, siç janë: krizat, periudhat zgjedhore, demonstratat publike, si dhe zonat e konfliktit.
- » Gazetarët duhet të posedojnë akreditime relevante dhe shenja dukshme gazetareske, ndërsa kur nuk është e mundur që gazetarët ose subjektet tjerë të medias të prodhojnë dokumentim profesional, duhet të bëhen të gjitha përpjekjet nga ana e organeve shtetërore për të përcaktuar statusin e tyre.
- » Nëpunësit shtetëror dhe personazhet publike nuk duhet të shkelin ose sulmojnë integritetin e gazetarëve në bazë të përkatësisë etnike, gjinisë, të akuzojnë, njoftosin ose ngjashëm.

Udhëzime thelbësore nga Rekomandimi në pjesën e PËRNDJEKJES PENALE

- » Një imperativ është që secili i përfshirë në vrasje, sulme dhe keqtrajttime ndaj gazetarëve dhe subjekteve tjerë të medias të nxirret para drejtësisë.
- » Kur personat përgjegjës për këto vepra penale nuk nxirren para drejtësisë, mund të paraqitet kultura e mosndëshkimit.
- » Hetimet për vrasje, sulme dhe keqtrajtim duhet të jenë efikase dhe gjatë kësaj të respektojnë kërkesat themelore për nivelin përkatës, hollësinë, paanësinë, pavarësinë, azhurnimin dhe vëzhgimin publik.

- » Hetimet duhet të jenë efektive në kuptim që ato të shpijnë deri te përcaktimi i fakteve, si dhe identifikimi dhe në fund ndëshkimi i personave përgjegjës.
- » Veçanërisht duhet të hetohet nëse dhuna është lidhur me aktivitet gazetaresk, apo gazetari hetimore.
- » Që të mund hetimi të jetë efektiv, personat përgjegjës për hetimin dhe ato të cilët zhvillojnë hetimin duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm, si me ligj ashtu edhe në praktikë. Secili person ose institucion i përfshirë në cilëndo mënyrë me ndonjë rast të caktuar duhet të përjashtohet nga pjesëmarrja në hetim.
- » Shtetet anëtare kanë për obligim të ndërmarrin gjitha hapat për të arrestuar kryerësit e veprave penale kundër gazetarëve dhe subjekteve tjerë të medias para drejtësisë, pa dallim nëse bëhet fjalë për funksionarë shtetëror ose jo.
- » Shtetet anëtare kanë për obligim të sigurojnë integritet të procedurave gjyqësore; ata duhet të garantojnë pavarësinë dhe paanshësinë e gjyqësorit. Trajnim mbi jurisprudencën për legjislaturën relevante të GJEDNJ-së.
- » Shtetet anëtare duhet t’ju sigurojnë në dispozicion viktimave dhe familjeve të tyre mjete efikase dhe përkatëse juridike, kompensime financiare, zhvendosje dhe strehim, etj.
- » Kur akuzat për krime kundër gazetarëve dhe subjekteve tjerë të medias nuk nisen ose pamundësohen në mënyra të ndryshme, krijohen shtyrje të papranueshme në zbatimin e drejtësisë dhe të njëjtat shkaktajnë mosndëshkimin e personave përgjegjës për krimet.
- » Kur një funksionar shtetëror akuzohet për krime lidhur me keqtrajtim, është kyçe që procedura penale dhe ndëshkimi mos të jenë të vjetërsuar.
- » Lufta kundër mosndëshkimit.

Udhëzime thelbësore nga Rekomandimi në pjesën e edukimit dhe ngritjes së vetëdijes

- » Shtetet anëtare (këtu nënkuptohet institucionet në “hallkën e mbrojtjes”) duhet të krijojnë një marrëdhënie PARTNERI me gazetarët, mediat, sektorin joqeveritar, shoqatat gazetareske dhe sindikatën për promovim të praktikave pozitive dhe luftë kundër mosndëshkimit.

REKOMANDIME PËR SIGURI TË GAZETARËVE NGA ORGANIZATAT EVROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE TË GAZETARËVE DHE MEDIAS

a) Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve (FNG)

Kjo organizatë paraqet organizatën më të madhe me anëtarësim të gazetarëve dhe punonjësve të mediave në nivel botëror që përfaqëson mbi 600.000 anëtarë nga 140 vende. FNG-ja vendos një theks të veçantë mbi sigurinë e gazetarëve dhe prandaj ka krijuar një fond të posaçëm që dedikohet për mbështetjen financiare të gazetarëve që kanë rreziqe sigurie. Përveç kësaj, kanë një blog të posaçëm që merret me informacionet më të reja mbi temën e sigurisë së gazetarëve ku sipas tyre në vitin 2018, përfshi edhe muajin gusht, janë vrarë 68 gazetarë në nivel botëror. FNG-ja ka shumë publikime në temën e përmirësimit të sigurisë së gazetarëve. Një prej më të theksuarave është “Udhëzuesi i Gazetarëve për Mbijetesë”⁹ që është publikuar në vitin 2003, por ende është aktual, veçanërisht kur raportohet për ngjarje specifike siç janë katastrofa natyrore, sulme terroriste, situata me pengmarrës, etj., ndërsa i njëjti mund të merret falas nga internet faja e tyre.

b) Gazetarë pa Kufij (GPK)

Sipas Gazetarë pa Kufij¹⁰, një prej organizatave më të njohura joqeveritare të pavarura me seli në Paris, Francë, që ka për mision mbrojtjen dhe promovimin e lirisë së shprehjes dhe informimit, raporton se vetëm në 6 muajt e vitit 2018, në gjithë botën janë vrarë 47 gazetarë profesionistë, gazetarë-qytetarë dhe punonjës të medias.¹¹

Gazetarë pa Kufij ju ndihmon gazetarëve dhe punonjësve të mediave që punojnë dhe raportojnë nga ngjarje me rrezik të lartë siç janë protesta, zona në konflikte dhe tjera të ngjashme por gjithashtu jep udhëzime për mënyrën e mbrojtjes së gazetarëve edhe në botën e internetit. Për anëtarët e saj ofron sigurim ndërkombëtar shëndetësor, dhuron jelekë anti-plumb dhe helmata falas për gazetarët që do t’i ekspozoheshin rrezikut të lartë, jep praktika

⁹ Udhëzues i Gazetarëve për Mbijetesë nga FNG-ja <http://ifj-safety.org/assets/docs/107/130/d325b-82b1d816b.pdf> qasur më 16 gusht 2018

¹⁰ Gazetarë pa Kufij <https://rsf.org/en/presentation> qasur më 12.08.2018

¹¹ “47 journalists, media workers killed in first half of 2018, RSF says” <https://rsf.org/en/news/-47journalists-media-workers-killed-first-half-2018-rsf-says> qasur më 12.08.2018

dhe rekomandime me anë të shpalljes së publikimeve për siguri të gazetarëve dhe ofron edukim për gazetarët mbi mënyrën e mbrojtjes në fushën e internetit.¹²

Në kontekstin lokal, do të kishim veçuar disa rekomandime nga Udhëzuesi¹³ për Gazetarë gjatë Kohës së Zgjedhjeve i publikuar bashkërisht nga Gazetarë pa Kufij dhe Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë në vitin 2010, ndërsa është plotësuar në vitin 2015. Gazetarët duhet të kenë mjedis më të sigurt të punës, veçanërisht të jenë të mbrojtur nga kërcënimet. “Secili gazetar duhet të denoncojë kushtet e pasigurta në mënyrën më të shpejtë, organizatave gazetareske, trupave rregullatorë, organizatave për të drejta të njeriut dhe organeve shtetërore, në të cilën në mënyrë të hollësishme do të përshkruajë të gjitha kërcënimet mbi të cilat është ekspozuar gazetari ose kolegët tjerë gazetarë.”

Masat e kujdesit, aspekti i neutralitetit dhe baraspesha:

- » Gazetari duhet të jetë i kujdesshëm kur bëhet fjalë për informacionet që i vendos në publik dhe burimet e informacioneve, duke u nisur nga rreziku më i lartë i manipulimit, informimi i gabuar është një armë e fuqishme e luftës;
- » Qasja të jetë rreptësisht neutrale; kjo i mundëson gazetarit të zbatojë punën në mënyrë më të sigurt të mundshme.
- » Gazetari të ketë kujdes për raportim të baraspeshuar. Për shembull, një gazetar që raporton nga ndonjë rajon ku opozita fton për bojkot të zgjedhjeve mund të bazojë punën në 4 lloje të burimeve: person që ka votuar nga bindja, person që nuk ka votuar nga frika e reperkusioneve nga ana e pushtetit, person që nuk ka votuar për të mbështetur kauzën e opozitës, person që ka qëndruar në shtëpi për shkak të frikës nga dhuna në vendvotimet.

Rregulla sigurie për gazetarët:

- » Çdoherë gazetarët me vete të mbajnë dokumentet e nevojshme për identifikim, letërnjoftim, kartelë për gazetari, akreditimin gazetaresk, autorizim për udhëtim ose dokument tjetër të ngjashëm.

¹² Gazetarë pa Kufij <https://rsf.org/en/guidelines-and-advice> qasur më 13.08.2018

¹³ “Handbook for journalists during elections” https://issuu.com/rsf_webmaster/docs/guide_oif_anglais__web qasur më 13.08.2018

- » Gazetari asnjëherë nuk duhet të mbajë armë ose shenja tjera ose rroba të cilat mund të rezultojnë me identifikimin e gabuar, uniformë ushtarake ose ngjashëm.
- » Asnjëherë mos të udhëtojë vetë, por vetëm me kolegë ose aktivistë të OJQ-ve. Lëvizja me grupin e kandidatëve ose liderët politik nuk rekomandohet.
- » Drejtimet e lëvizjes së gazetarit të planifikohen me kujdes për të shmangur zonat e konfliktit. Në mënyrë të rregullt të dërgohen informacione për vendndodhjen deri në redaksi ose ndonjë miku ose anëtar i familjes.
- » Të shmanget udhëtimi gjatë natës dhe të ketë kujdes nga orët policore nëse ekzistojnë të tilla në atë pjesë.
- » Kur raportohet nga mitingu politik, të kontrollohet terreni dhe të identifikohet vendi i strehimit në rast të dhunës.
- » Nëse ndodhin incidente, nuk duhet të vrapohet, sepse ajo zmadhon rrezikun që të bëheni cak. Mos u transferoni drejtpërdrejtë nga njëra palë kundërshtuese në tjetrën.

Raportim nga zgjedhje gjatë situatave të dhunshme:

Mediat mund të luajnë një rol të rëndësishëm në konsolidimin e paqes dhe demokracisë. Por gjithashtu, mund edhe të shkaktojnë konflikt me anë të përhapjes së thashethemeve, propagandës, mosbesimit ose urrejtjes mes qytetarëve dhe komuniteteve.

Një rrezik tjetër është që mediat me nivel të ultë të profesionalizimit mund të përdorin terminologji të papërshtatshme/të fryrë pa mos kuptuar efektin që ajo mund të shkaktojë. Fushata zgjedhore është një shembull i përkryer i shprehjes jo shembullore, që del nga debatet politike dhe mund të shndërrohet në të folurit e dhunshëm.

Rreziku është madje më i lartë kur zgjedhjet organizohen në vend që ka qenë në konflikt ose në ndonjë vend që ka tension në klimën politike dhe është në konflikt të vazhdueshëm. Proces i zgjedhor mund të zmadhojë ndarjet dhe dallimet ose arsyet që kanë rezultuar me konflikt dhe manifestohen në konflikt politik.

Përmbledhje e rregullave për gazetarë që raportojnë nga procese zgjedhore:

Për shkak të numrit të madh të sfidave që dalin nga një proces zgjedhor, gazetarët duhet të respektojnë parimet themelore etike të profesionit të tyre. Informacionet që i publikojnë duhet të jenë të sakta, të verifikuara, të baraspeshuara, neutrale dhe të respektojnë dinjitetin njerëzor. Gazetarët çdoherë duhet të kenë parasysh që i mbrojnë interesat e qytetarëve të rëndomtë.

- » Gazetarët të jenë të vetëdijshëm për të drejtën e tyre dhe detyrimin të flasin me gjitha partitë dhe kandidatët, përfshi edhe ata që sillen në mënyrë armiqësore kundër autoriteteve. Të gjitha temat e rëndësishme për votuesit dhe të ardhmen e tyre janë tema të përshtatshme për të raportuar. Ekzistojnë pak baza ligjore për kufizim të lirisë së shprehjes dhe në asnjë rast ata nuk duhet të kufizojnë prezantimin e ideve të ndryshme ose mendimeve.
- » Gazetarët kanë për obligim të prezantojnë informacione të sakta dhe të kontrolluara dhe të sigurojnë që puna e tyre është e besueshme. Lajmet duhet të prezantohen në frymën e modestisë, rreptësisë faktike dhe hulumtimit skeptik dhe jo me konkluzione të rritura tej mase.
- » Gazetarët duhet të prezantojnë qëndrimet e të gjithë kundërshtarëve politik, gjatë prezantimit të programeve dhe debateve, pa mos imponuar mendimin e tyre personal. Reportazhet në asnjë mënyrë nuk guxojnë të tentojnë të udhëheqin votuesit për cilin kandidat të përcaktohen.
- » Aspekti i redaktorit duhet të jetë i pavarur dhe rezistues ndaj gjitha presioneve politike, sociale dhe financiare që janë të dizajnuar të ndikojnë mbi raportimin. Gazetarët duhet të udhëhiqen nga rekomandimet e redaktorëve dhe nga kuptimi individual i parimeve etike.
- » Gazetarët të jenë të vetëdijshëm për efektet, ato pozitive dhe negative, që i kanë krijuar me publikimin e ndonjë informacioni. Në këtë kuptim lajmet duhet të jenë neutrale dhe mos të përmbajnë fjalime sensacioni. Temat me të cilat në mënyrë potenciale do të rrisnin tensionet duhet të shqyrtohen me kujdes maksimal.

c) Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve (KMG)

Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve është një organizatë e pavarur, jofitimprurëse që promovon liri të mediave në nivel botëror. Komiteti mbron të drejtën e gazetarëve që të raportojnë pa frikë nga hakmarrja. Komiteti përbëhet nga 40 ekspertë nga gjitha anët e botës, me seli në Nju Jork. Në rast të paraqitjes së shkeljeve të lirisë së shtypit, KMG-ja mobilizon një rrjet të korrespondentëve që raportojnë dhe marrin masa për palët e cenuara. KMG-ja raporton për shkelje në regjime represive, zona të konfliktit ose demokraci të vendosura. Një Bord i gazetarëve eminent nga e gjithë bota ndihmon që të orientohen aktivitetet e KMG-së.¹⁴

Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve ka publikuar një Udhëzues ¹⁵ për Siguri të Gazetarëve nga autori Frank Smith, këshilltar i lartë për siguri të gazetarëve pranë Komitetit. Ky udhëzues përmbledh atë që gazetarët duhet të kenë parasysh në një botë të re dhe të ndryshuar. Një botë që gjithnjë e më tepër bëhet vend i rrezikshëm për punën e gazetarëve. Mesatarisht, më tepër se 30 gazetarë vriten çdo vit nëpër botë, ndërsa vrasësit mbeten të pandëshkuar në 9 prej 10 rasteve. Qindra gazetarë çdo vit sulmohen, janë nën kërcënim ose keqtrajtohen. Shumica prej tyre vëzhgohen në mënyrë fizike, ndërsa komunikimet në telefon dhe internet kontrollohen. Më tepër se 150 gazetarë janë në burg në çdo kohë, disa pa mos qenë të gjykuar për vepër penale. Vendndodhja e së paku 35 gazetarëve është e panjohur. Me anë të profesionit të tyre gazetarët janë të ekspozuar në stres emocional çdoherë kur raportojnë nga ngjarje ku ka dhimbje ose humbje të jetës, keqpërdorim seksual të fëmijëve ose sulme terroriste mbi civilë.

Udhëzuesi i dedikohet gazetarëve lokal dhe ndërkombëtar me nivel të ndryshëm të përvojës profesionale, dhe gjithashtu prezanton përgatitjet themelore të nevojshme për gazetarë që për herë të parë raportojnë nëpër botë, ofron informacione për gazetarë që kthehen në teren dhe ofron këshilla për çështje të ndërlikuara siç janë siguria digjitale dhe vlerësimi i rrezikut për gazetarë me nivel të ndryshëm të përvojës.

¹⁴ Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve <https://cpj.org/about/> qasur më 13.08.2018

¹⁵ Manual për Siguri të Gazetarëve <https://cpj.org/reports/04/2012/journalist-security-guide.php> qasur më 13.08.2018

Aksidente, zjarr dhe skenarë të shpëtimit:

Përgjegjësia më e rëndësishme e secilit që i pari do të gjendet në këtë lloj të ngjarjes, pavarësisht a ka qenë policia, personat nga automjetet e ndihmës së shpejtë, zjarrfikësit ose gazetarët, është të mbrojnë vetveten me atë që do të analizojnë mjedisin dhe do të identifikojnë rreziqe të caktuara potenciale, si aksident trafiku, tela rryme të rrëzuara (energji elektrike), rrjedhje të materieve të djeshme, gazra ose lëndë kimike. Ngjashëm me situatat tjera, gazetarët duhet të jenë mjaft afër që të kenë pasqyrim të ngjarjes, por pa mos ekspozuar veten ose tjerët në rrezik ose të pengojnë operacionet e sigurisë ose shpëtimit. Fotoreporterët duhet të respektojnë rregullat e njëjta, dhe duhet të jenë mjaft afër për të regjistruar pamje nga ngjarja. Organet zakonisht vendosin një perimetër sigurie për të mbajtur personat kureshtarë madje edhe gazetarët në distancë. Rekomandimi është që organet t'ju sigurojnë gazetarëve një vend prej të cilit do të kenë një pasqyrë të pastër për ngjarjen. Për të arritur këtë qëllim, duhet të ketë një komunikim të vazhdueshëm mes personave përgjegjës dhe gazetarëve, me të cilën do të vendosen drejtimet e përbashkëta të raportimit nga këto ngjarje. Theksimi i kartave të shtypit në vend të dukshëm nga ana e gazetarëve gjatë raportimit të ngjarjeve urgjente është tepër e rëndësishme.

Ngjarje kriminele dhe terroriste:

Gjatë raportimit nga ngjarjet ku ka krim të dhunshëm ose sulm terrorist, sërish siguria personale është në rend të parë. Me rëndësi është që gazetarët të pyesin nëse kryerësit ndoshta janë ende në afërsi të ngjarjes, nëse në rast të sulmit terrorist do të mund të ketë përsëritje të sulmit, sepse rekomandimi është që të qëndrohet në periferi të vendit dhe të merren deklarata nga dëshmitarë që largohen nga vendi i ngjarjes. Sërish, në vend të dukshëm duhen të theksohen kartat e shtypit për identifikim, të mirëmbahet relacioni profesional me organet, të shmangët kontakt me lëndë që do të mund të jenë dëshmi potenciale, me rëndësi është të mos traumatizohen më tepër personat e mbijetuar ose dëshmitarët, çdoherë gazetarët duhet të pyeten nëse kjo është koha më e mirë për të parashtruar pyetje.

Protesta dhe trazira:

Gazetarët që mbulojnë dhe raportojnë nga protesta dhe trazira mund të përballohen me rreziqe ligjore dhe fizike. Sipas KMG-së, rreth 100 gazetarë kanë vdekur gjatë raportimit nga protesta ose ngjarje të ngjashme prej vitit 1992 deri më vitin 2011. Përgatitja paraprake fizike është shumë e rëndësishme për një gazetar që vendos të raportojë nga këto ngjarje që në çdo moment mund të bëhen të dhunshme. Gazetari çdoherë duhet të ketë parasysh vendin në të cilin gjendet, gjegjësisht vendi i përshtatshëm për raportim që do të mundësojë siguri dhe mënyrë të shpejtë të tërheqjes në rast të rrezikut. Pajisja e detyrueshme është e rekomanduar, si për shembull, helmetë dhe jelek mbrojtës, çantë me shishe ujë, maske për fytyrën në rast të përdorimit të gazit lotsjellës, syze mbrojtëse dhe të ngjashme. Vetëm gazetarët, fotoreporterët dhe kameramanët me përvojë rekomandohet që të raportojnë nga ngjarje të tilla ose se paku të shoqërojnë kolegët më të rinj.

PJESA II

**AUTOR:
SPASENKA ANDONOVA,
PROKURORE PUBLIKE**

PROKURORIA PUBLIKE DHE MEDIAT

Publiku dhe transparenca në punën e të gjitha institucioneve, përfshi edhe Prokurorinë Publike, janë shtyllat kryesore mbi të cilat duhet të ndërtohet besimi i publikut.

Prokuroria publike është e obliguar të informojë publikun për raste mbi të cilat veprohet, veçanërisht nëse shkaktojnë interes më të gjerë në publik, por njëkohësisht PP-ja është organ që kujdeset për mbrojtjen e të drejtave të personave të përfshirë në procedura penale, që do të thotë se mënyra në të cilën do të shpërndajë një informacion me publikun për ndonjë ngjarje ligjore penale duhet të jetë mirë e zgjedhur dhe drejtë e përpiluar që mos të shkelet parimi i supozimit të pafajësisë.

Ky obligim për Prokurorinë Publike ekziston edhe në rast kur kjo e drejtë shkelet nga ndonjë organ tjetër, institucion ose organizatë, përfshirë edhe mediat.

Parimi i aspektit publik i procedurave gjyqësore dhe liria e të shprehurit janë parime që si standard ndërkombëtar në tërësi inkorporohet në legjislaturën kombëtare. Aspekti publik, karakteri publik i procedurës është karakteristikë themelore e gjyqësorit të drejtë. Dorëzimi i informacioneve me qëllim që të sigurohet raportim i mediave duhet të jetë në përputhje me të drejtat e gjithë personave të përfshirë në procedurë, ku rëndësi të veçantë ka mënyra në të cilën këto informacione do të transmetohen, prezantohen, formulohen.

Megjithatë, përdorimi i të drejtave dhe lirive mund të kufizohet me ligj, me qëllim të vetëm që të sigurohet njohja e detyrueshme dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe me qëllim të plotësisimit të kërkesave ligjore për moral, rend publik dhe mirëqenie të përgjithshme në një shoqëri demokratike.

Vetëm një informacion i saktë dhe preciz, i bazuar në fakte relevante duke theksuar përshkrim të saktë dhe ligjor në fazën e veprimit, veçoritë dhe pozitat e personave të përfshirë, me përdorimin e terminologjisë së drejtë juridike, do të thotë informim i drejtë, pa shqyrtime subjektive dhe mendime të atij që bën transmetimin e këtij informacioni.

Mosnjohja e dispozitave ligjore, kornizës ligjore, procedurave rezultuese, mosnjohja e kompetencave të institucioneve të përfshira, lloji i veprimeve që secili prej tyre i ndërmerr shpjen drejt në vendosje të informacioneve të gabuara, të pabazuara dhe të pakontrolluara.

Me anë të informimit sipërfaqësor dhe të pasaktë shumë lehtë mund të krijohet një perceptim negativ, pasqyrë negative për punën e Prokurorisë Publike, gjegjësisht të prishet imazhi dhe besimi i institucionit.

Transmetimi i drejtë i informacioneve me përdorimin e formulimeve dhe termeve të shkurta, të qarta dhe precize, në mënyrë efektive e informojnë edhe qytetarin e rëndomtë, që nuk duhet medoemos të vijë në kontakt të përditshëm me terminologjinë dhe specifikat e procedurave gjyqësore.

Prokuroria Publike tani ka një rol shumë të rëndësishëm në procedurën penale, dhe me këtë edhe përgjegjësi më të lartë për çdo hap të ndërmarrë në procedurë, përfshi edhe në lidhje me informimin e publikut.

Mbyllja e mëparshme e Prokurorisë Publike, si institucion, mungesa e bashkëpunimit me mediat dhe mungesa e shkëmbimit të informacioneve me publikun kanë kontribuar që të krijohet një pasqyrë që në opinion dihej vetëm për veprimin e MPB-së - me anë të konferencave për shtyp ose buletineve të publikuar, dihej për punën e Gjykatave me anë të pranimeve në proceset gjyqësore dhe vendimet gjyqësore të miratuara, ndërsa Prokuroria Publike thjeshtë ishte kaluar si një hallkë e padukshme në këtë zinxhir, pasi askush nuk informonte mbi punën e Prokurorisë Publike.

Ky vakum ka lënë mundësi për shumë spekulime në lidhje me punën e Prokurorisë Publike, gjegjësisht një imazh të gabuar për atë se çfarë punon Prokuroria Publike, madje edhe shpesh përzierje në përgjegjësitë e PP-së, dhe cilat janë përgjegjësitë e palëve tjera.

Gjatë viteve të fundit punohet shumë në hapjen e Prokurorisë Publike si institucion në lidhje me mediat dhe publikun. Për momentin bashkëpunimi është ngritur në nivel më të lartë nga ajo që ishte filluar, por duhet të punohet edhe më shumë mbi ngritjen e transparencës në nivel më të lartë dhe mbi llogaridhënien për punën.

Me anë të Shërbimit të porsa formuar për marrëdhënie me publikun, është lehtësuar qasja në informacione për institucionet, mediat dhe publikun. U mundësua bashkëpunimi i rregullt dhe komunikim që prokurorët publik e kanë jo vetëm me Shërbimin për marrëdhënie me publikun për shkak të shkëmbimit të informacioneve me kohë për lëndë më të rëndësishme, por edhe me palët në gjykatë, të punësuarit në MPB, policinë financiare, doganat dhe institucionet tjera.

Në drejtim të sigurimit të transparencës dhe përforsimit të besimit të publikut për punën e Prokurorisë Publike, në kohën e fundit janë miratuar akte ligjore me të cilat përshkruhet mënyra e realizimit të komunikimit me publikun (Udhëzime për Marrëdhënie me Publikun nga viti 2014 dhe Strategjia për Marrëdhënie me Publikun për Prokurorinë Publike për vitet 2016-2018 bashkë me Planin e Veprimit për zbatimin përkatës).

Për të përmirësuar transparencën e prokurorisë publike aktualisht janë duke u zbatuar disa aktivitete që kanë të bëjnë me kornizën e re ligjore dhe vendosjen organizative të marrëdhënieve me publikun.

BASHKËPUNIMI MES MPB-SË, PP-SË DHE MEDIAVE

Komunikimi i mirë do të thotë edhe bashkëpunim i mirë me shërbimet tjera për marrëdhënie me publikun në institucione, dhe me këtë kuptohet edhe me mediat. Ky bashkëpunim nënkupton veprim të koordinuar me anë të sinkronizimit të shërbimeve për informim të publikut, si në kuptim të kohës së duhur, ashtu edhe në kuptim të përmbajtjes duke pasur kujdes vazhdimisht në mbrojtjen e të drejtës së supozimit të pafajësisë, informimit të saktë për veprimet e ndërmarra dhe personat e përfshirë në realizimin e tyre. Me sinkronizimin shmanget edhe gjendja e një gare të dukshme mes institucioneve dhe marrja e meritave për arritjet.

Në të kundërtën, prishet baraspesha e informimit të drejtë, veçanërisht nën shtypje të publikut dhe mediave në kuptim të sigurimit të shpejtë të informacioneve. Kjo veçanërisht vlen në situata të aksidenteve, katastrofave elementare, tragjedive familjare, ngjarje në të cilat përfshihen një numri i madh i personave, gara sportive dhe të ngjashme.

Para njoftimit të publikut për çështje më të rëndësishme, veçanërisht për veprim në raste të veprave të rënda penale, policia ka për detyrë të njoftojë prokurorin përgjegjës publik. Nëse prokurori publik vlerëson që informacionet në tërësi ose pjesërisht nuk mund të shpalosen para opinionit të gjerë, policia ka për obligim të veprojë në përputhje me vlerësimin e prokurorit publik.

Duhet të sigurohet zbatim i drejtë i dispozitës së Nenit 289 të LPP-së që ka të bëjë me fshehtësinë e të gjitha veprimeve që janë të ndërmarrë në procedurë para hetimore. Prokurori publik dhe nëpunësit policor nuk mund të shpërndajnë informacione mbi përmbajtjen dhe mënyrën e kryerjes së aktiviteteve konkrete në kuadër të procedurës para hetimore.

Kjo ngurtësi në lidhje me rregullat për publikun dhe transparenca në punën e institucionit është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për fëmijë – viktime ose dëshmitarë nën moshën 16 vjeçe ose persona me nevoja të posaçme, si dhe nëse bëhet fjalë për informacione të përcaktuara me kualifikim të shkallës tepër sekrete, sekret zyrtar ose shtetëror.

Prokuroria Publike dhe policia e jurisprudencës bashkëpunojnë në lidhje me mënyrat e zbatimit të hetimeve për veprën penale, për zbatim të veprimeve hetimore, masa të posaçme hetimore gjatë hetimit dhe procedurës penale, gjatë së cilës policia detyrimisht njofton prokurorin publik për baza të dyshimit që është kryer veprë penale për të cilën persekutohen me detyrë zyrtare ose për fillimin e hetimit penal.

Prokurori Publik është ai që do të vendos kur dhe në çfarë faze është e nevojshme shkëmbim i informacioneve për ndonjë rast të caktuar penal ligjor, megjithatë ka obligim për informim për një lloj të veprave penale të kryera, veçanërisht për ato vepra penale që nga natyra shkaktojnë interes më të lartë të publiku. Duhet pasur kujdes edhe për rregullat e shtrirjes së brendshme të Prokurorisë Publike – parimi i hierarkisë dhe vartësisë, ashtu që edhe mënyra e transmetimit të informacioneve prej të cilëve më vonë do të nxirren të dhënat themelore për informim të publikut, e ndjek këtë linjë.

Në këtë mënyrë realizohet komunikim i suksesshëm i brendshëm në kuadër të vetë institucionit, dhe me atë ka edhe mundësi për reagim me kohë nga ana e Prokurorit Publik shtetëror në situata kur konsideron që të dhëna të caktuara ose komentet e publikuara në media i shkelin të drejtat kushtetuese të supozimit të pafajësisë, parimit të pavarësisë së Prokurorisë Publike ose punës së Prokurorisë Publike, duke reaguar në publik si rezultat i detyrës për të treguar që këto parime janë shkelur.

Ky obligim i Prokurorit Publik ekziston posaçërisht në situata kur është i njoftuar për ndonjë ngjarje që mund të shkaktojë interes të rritur në publik për shkak të karakterit përkatës, peshës ose specifikës, andaj nevojitet veprim i shpejtë, gjegjësisht marrja e masave me qëllim që në fillim të sigurohen sa më tepër informacione dhe dëshmi, dhe gjatë kësaj të kënaqet edhe interesi i publikut, me respektimin e plotë të të gjitha standardeve ndërkombëtare dhe vendore që kanë të bëjnë me të drejtën e qasjes së lirë në informacione dhe të drejtën e të shprehurit të lirshëm.

Kjo është veçanërisht e vështirë kur për shkak të përcaktimit dhe sqarimit të ndonjë fakti të rëndësishëm në procedurë duhet dhënë shënime të menjëhershme, gjegjësisht kur përdoret kontrolli si mjet dëshmie.

ROLI I PP-SË, MPB-SË DHE GAZETARËVE GJATË KOHËS SË KONTROLLIT

Kryerja e kontrollit është një proces i ndërlikuar i identifikimit, gjetjes, shënimit dhe sigurimit të materialeve për dëshmi, gjatë së cilës duhet të ketë kujdes për kushtet klimatike dhe ambientale me qëllim të marrjes dhe ruajtjes së tyre përkatëse. Secili hap dokumentohet, fotografohet dhe shënohet.

Në raste të caktuara zbatimi i veprimeve hetimore mund të incizohet, në përputhje me nenin 94 të LPP-së, me aparate për regjistrim vizual-tonik kur është përcaktuar me këtë ligj. Mund të sigurohen informacione nga persona, qytetarë dhe persona tjerë që mund të jenë dëshmitarë gjatë procedurës.

Aspekti specifik i procedurës, si dhe lënda dëshmuese është ajo që shpesh zbatohet në vend publik, në sipërfaqe të hapura, në afërsi të shumë qytetarëve që rastësisht ose me qëllim, nga kureshtja, gjenden ose qëndrojnë në atë vend. Shpesh ndodh që pas marrjes së informacionit për ngjarjen, në vend të ngjarjes, paralelisht me nëpunësit policor, të arrijnë edhe ekipe gazetareske.

Kjo kërkon angazhim plotësues të nëpunësve policor që duhet në kohën e njëjtë të sigurojnë dhe të ruajnë të gjitha dëshmitë e mundshme, në perimetër përkatës, dhe gjatë kësaj të ndalojnë kontaminimin e vendit nga prania e personave tjerë, deri në fillimin e zbatimit të veprimeve para hetimore, qoftë ajo nën udhëheqjen e prokurorit publik ose me autorizimin e tij, policinë. Prokurori Publik e merr rastin për kontroll në rast se ka baza për dyshim që janë kryer vepra penale ku si pasojë ka pasur vdekje ose ka gjasa që kjo pasojë të ndodh më tutje.

Kontrolli ndërmerret edhe kur ka dëme të pronës në përmasa të mëdha, shkatërrim të objekteve me rëndësi më të madhe për ekonominë ose për jetën e rëndomtë të qytetarëve, kur është shkaktuar eksplozim, zjarr, vërshime ose është ndërmarrë ndonjë veprim tjetër i rrezikut të përgjithshëm me pasoja të rënda, gjatë rasteve të aksidenteve të rënda, aksidenteve ajrore ose hekurudhore ku ka viktimë në njerëz ose ka një numër më të lartë të personave të lënduar.

Prokurori Publik ka obligim të del në vendin e ngjarjes gjatë aksidenteve të trafikut me pasoja më të rënda në të cilën ka marrë pjesë automjet nga ndonjë përfaqësi diplomatike ose

konsullore, automjet policor, automjet i Armatës, gjatë rasteve të formave të rënda të veprave penale në të cilat ka marrë pjesë person zyrtar, përfaqësues shtetëror, diplomatë të huaj ose përfaqësues konsullor ose person i njohur televiziv, por edhe në gjitha rastet tjera ku Prokurori Publik do të vlerësojë që prania e tij gjatë kontrollit është e domosdoshme.

Gjatë kryerjes së kontrollit, gazetari mund të merr informacione të shkurta dhe të përgjithshme mbi ngjarjen dhe nuk duhet të kërkojë informacione plotësuese nga nëpunësit policor ose prokurori publik që gjendet në vendin e ngjarjes, por nga shërbimi përkatës që është përgjegjëse për informim.

Kur Prokurori Publik të përfundojë me zbatimin e lëndës dëshmuese dhe do të dërgojë informacione te Shërbimi për Marrëdhënie me Publikun, pas respektimit paraprak të të gjitha rregullave të brendshme për dërgimin e njoftimeve, mediet do të mund të marrin informacione të mjaftueshme që mund të prezantohen, me qëllim të parandalohet publiciteti i dëmshëm para fillimit të procedurës gjyqësore.

Shumë shpesh ndodh që në vende ku ka baza për dyshim që është kryer vepër penale, gazetarë të arrijnë dhe të fillojnë të incizojnë ngjarjen, objektin, madje edhe personat që në atë kohë kanë qëlluar në atë vend. Këto incizime mund të përdoren si dëshmi gjatë procedurës, nëse vlerësohet që ajo është e nevojshme, për shkak të aspektit origjinal dhe specifikat në lidhje me të dhënat që përmban, vetëm nëse paraprakisht janë siguruar në formë dhe procedurë të përcaktuar me ligj.

Në sigurimin e dëshmive mund të kontribuojnë edhe informacionet që do të gjejnë gazetarët, pas arritjes së tyre në vendin e ngjarjes, sepse qytetarët ndjehen më të lirë të japin deklarata para kamerave, sesa të japin sqarime para nëpunësit policor ose prokurorit publik.

Procesi i kontrollit të disa njohurive, informacioneve për një ngjarje të caktuar penale ligjore si dhe sigurimi i dëshmive materiale e imponon nevojën e gjetjes dhe sigurimit të përkohshëm të gjërave që mund të shërbejnë si dëshmi gjatë procedurës. Kjo mund të bëhet me urdhër për sekuestrim të përkohshëm të gjërave, që jepet nga gjykata për policinë gjyqësore ose prokurorinë publike. Disa situata të caktuara kërkojnë edhe sekuestrimin e përkohshëm të gjërave pa urdhër të gjyqit, nëse ka rrezik nga shtyrja dhe për të cilat ka baza të dyshimit që janë lëndë të veprës penale.

Për gazetarin ekziston obligim që të njoftojë nëpunësin policor ose prokurorin publik që do të arrijnë në vendin e ngjarjes nëse i posedon këto incizime, dhe pas vlerësimit të prokurorit publik dhe pas urdhrimit të dhënë në kërkesë të tij, këto incizime të sigurohen dhe përdoren gjatë procedurës.

Megjithatë, me urdhër gjyqësor nuk mund të merren shkresa për fakte që i kanë bërë gazetarët dhe redaktorët e tyre në mjetet për informim nga burimi për njoftim dhe të dhëna për të cilat i kanë kuptuar gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre dhe që janë përdorur gjatë redaktimit të mjeteve për informim publik, që gjenden në qeverisjen e tyre ose në redaksinë në të cilën janë të punësuar¹⁶.

Personi që ka siguruar këto incizime mund të përdoret edhe si dëshmitar gjatë procedurës, nëse ka shkaqe të arsyetueshme për këtë. Kjo mundësi del nga neni 212 dhe neni 285 i LPP-së, që sipas dispozitave përkatëse, prokurori publik mund të ftojë persona që kanë njohuri dhe që mund të kontribuojnë për sqarimin e fakteve kontestuese gjegjësisht si dëshmitarë të ftoj persona që me siguri do të mund të japin njoftime për veprën penale, kryerësin ose rrethana tjera përkatëse.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse bëhet fjalë për incizim dhe informim të ngjarjeve ku ka prani të madhe të personave: ngjarje sportive, protesta, mbledhje publike të cilat më vonë të shndërrohen në reagime të dhunshme dhe të manifestohen me anë të sulmeve fizike, përdorime të mundshme të armëve të rrezikshme ose armëve të zjarrit dhe tjera, andaj këto incizime mund të shërbejnë për të mësuar mbi ngjarjen, dhe pastaj edhe për orientimin e kontrolleve të nevojshme dhe identifikimin e kryerësve të mundshëm. Ky obligim shpeshherë është në konflikt të drejtpërdrejtë me dëshirën dhe obligimin e gazetarëve që shpejtë të arrijnë në informacione dhe menjëherë të transmetojnë këto informacione para publikut.

¹⁶ Ligji për Procedurë Penale

PJESA III

**AUTORË:
IVAN BRESHKOVSKI, AVOKAT,
TONI ANGELLOVSKI, MPB**

NË ÇFARË MËNYRE TË VEPROJNË GAZETARËT, FOTOREPORTERËT DHE PUNONJËSIT E MEDIAS NË RAST TË RREZIKUT

Si të veprojnë gazetarët kur janë të sulmuar nëpër mbledhje publike:

Nëse ndonjë gazetar sulmohet gjatë ndonjë mbledhje publike ose ndonjë ngjarje tjetër, menjëherë ose në kohën më të shpejtë duhet të denoncojë rastin në stacion policor dhe të prezantojë gjithë detajet dhe dëshmitë që do të ndihmonin në identifikimin e kryerësit. Kështu policia do të formojë lëndë dhe do të vazhdojë të veprojë. Gazetarët duhet të denoncojnë secilin rast në polici sepse policia vepron vetëm në bazë të denoncimit përkatës.

Rekomandohet që gazetari në afatin më të shkurtë të denoncojë rastin në shoqatat artizane gazetareske me qëllim që të bëhet një reagim publik, dënim dhe monitorim të procedurës dhe nëse ka nevojë, edhe sigurim të ndihmës juridike.

Si të veprojnë gazetarët kur janë të sulmuar në hapësirën e internetit:

Nëse ndonjë gazetar përballohet me kërcënime ose gjuhën e urrejtjes në hapësirën e internetit, rrjetet sociale dhe ngjashëm, kjo mund të denoncohet në adresën e postës elektronike cybercrime@moi.gov.mk dhe pastaj duhet të parashtrijë kërkesë denoncimi edhe në MPB, ku do të përpilohet procesverbal për pranimin e denoncimit. Më tutje, MPB-ja njofton prokurorinë përgjegjëse që pastaj ka për obligim të jep drejtime konkrete për veprim në përputhje me Kodin Penal. Varësisht nga ajo se për çfarë veprë penale bëhet fjalë, veçanërisht për vepra penale lidhur me rrjetet sociale pas kërkesës zyrtare të kërkuar nga PP-ja kompetente, MPB-ja dërgon kërkesën te rrjetet sociale për mbledhjen e të dhënave. Pastaj vijon analiza, përcaktimi i përdoruesit me IP adresën dhe ngjashëm, për të arritur tek informacionet për përcaktimin e kryerësit të veprës penale dhe parashtrimin të aktit përkatës kundër kryerësit.

Gjatë denoncimit të veprës penale nga fusha e krimit kompjuterik, me rëndësi është që të dihet URL lidhja e saktë, të bëhet „print-screen“ (kopje e) faqes kontestuese, fotografitë që janë publikuar, si dhe çdo dokument tjetër që mund të ndihmojë gjatë hetimit.

MASA AKTIVE DHE REKOMANDIME PËR SIGURI TË GAZETARËVE, FOTOREPORTERËVE DHE PUNONJËSVE TË MEDIAS GJATË RAPORTIMIT NGA NGJARJET ME RREZIK TË LARTË

A) REKOMANDIME për sigurinë e gazetarëve:

- » Redaksitë të sigurojnë pajisje të nevojshme mbrojtëse për gazetarët dhe fotoreporterët në kushte kur ata raportojnë nga ngjarje me rrezik të lartë. Me pajisje nënkuptohet: jelek mbrojtës, helmetë ose kapelë me material të fortë, dhe sipas nevojës edhe maskë për mbrojtje nga lëndë kimike që përdoren për shpërndarjen e turmave të njerëzve.
- » Redaktorët mos të dërgojnë gazetarët e rinj dhe pa përvojë të raportojnë nga ngjarje me rrezik të lartë, posaçërisht pa shoqërimin e kolegëve më të vjetër me përvojë, dhe përveç kësaj, ata kanë për obligim të informojnë gazetarët për rrethanat me të cilat do të përballohen para se të dërgohen në teren. Gazetarët çdoherë duhet me kujdes të llogaritin rrezikun dhe të ndjekin vendimet e kolegëve të tyre me më shumë përvojë.
- » Gazetarët me vete të mbajnë dokumente e duhura për legjitimim dhe shenja përkatëse, e këto të vendosen në vende të dukshme, në të cilat qartë do të vërehet që bëhet fjalë për gazetar ose fotoreporter.
- » Gazetarët duhet të respektojnë rekomandimet specifike të policisë, por nëse imponohet ndalesë e papërshtatshme për raportim atëherë duhet që gazetarët bashkërisht të reagojnë te personi i autorizuar zyrtar.
- » Raportimi në raste të prishjes së rendit publik dhe qetësisë nga ana e turmave të caktuara ose grupeve duhet të bëhet në mënyrë që mos të provokohen grupet dhe të raportohet nga distancë e sigurt.
- » Në raste kur policia shpërndan turmën, gazetarët nuk duhet të vrapojnë para policisë sepse në të kundërtën policia do të konsiderojë që ata janë pjesë e turmës. Gazetarët duhet të lëvizin në mënyrë normale pas policisë, që do sigurojë hapësirën në raste kur shpërndan turma dhe mos të pengojnë punën e policisë.

- » Duhet që gazetarët mirë të mësojnë hapësirën në të cilën zhvillohet protesta publike dhe në rast të përkeqësimit në protestë të dhunshme, nëse ka nevojë, të kalojnë në distancë të sigurt.
- » Në raste kur ka dy ose më tepër protesta në një hapësirë, me rëndësi është që gazetarët mos të gjenden në mesin e dy turmave të kundërshtuara por të lëvizin nga pjesa anësore, paralelisht me personat që janë pjesë e protestave.
- » Gazetarët të zbatojnë detyrën e tyre në mënyrë profesionale dhe në përputhje me Kodin e Gazetarëve, si dhe mos të përdorin gjuhë të urrejtjes ose gjuhë tjetër diskriminuese.

B) REKOMANDIME për gazetarë në rast të sulmit ose kërcënimit:

- » Gazetari, fotoreporteri ose punonjësi i medias ka për obligim të denoncojë tek MPB çdo sulm ose kërcënim drejtuar atyre, anëtarëve të afërt të familjes ose kolegëve tjerë pa dallim nëse incidenti ka ndodhur në momentin kur gazetari ka qenë në detyrë (teren), ose sulmi apo kërcënimi ka ndodhur jashtë orarit dhe vendit të punës.
- » Në raste kur sulmi kundër gazetarit, fotoreporterit ose punonjësit të medias është nga ana e ndonjë personi zyrtar- pjesëtari të MPB-së, procedura është e njëjtë sikur edhe në gjitha rastet tjera, denoncohet rasti ku menjëherë aktivizohet Departamenti për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde profesionale pranë MPB-së.
- » Në raste kur janë shkaktuar lëndime trupore, duhet të kërkohet ndihmë mjekësore dhe pastaj të kërkohet raporti mjekësor në të cilin do të theksohen lëndimet e pësuar. Kjo është me rëndësi, sepse më vonë raporti mund të përdoret si material dëshmie në procedurat për mbrojtjen e të drejtave të personit të dëmtuar para gjykatave kompetente.
- » Gazetarët, fotoreporterët ose punonjësit e medias duhet të drejtohen edhe tek organizatat artizane për të marrë ndihmë juridike dhe për shkak të nevojës që incidenti të regjistrohet, të aktualizohet më tutje dhe të vëzhgohet veprimi nga ana e institucioneve kompetente.

- » Në raste kur gazetari privohet nga liria nga ana e ndonjë personi zyrtar, duhet që të qëndrohet i qetë, të thekson se raporton në mënyrë zyrtare dhe që është në detyrë dhe që është gazetar, fotoreporter ose lloj tjetër i punonjësit të medias. Përveç kësaj, mund të tregojë kartën e shtypit dhe dokument për identifikim. Për gazetarin, ngjashëm edhe si për gjithë qytetarët, vlejnë ligjet dhe ato duhet të respektohen dhe nëse një person zyrtar kërkon nga gazetari legjitimim sipas ligjit, gazetari ka për obligim të bëjë atë, ndërsa mbajtja e letërnjoftimit është detyrim sipas ligjit.
- » Gazetarët kanë mundësi ligjore nëse konsiderojnë që ndonjë nëpunës policor i ka tejkaluar autorizimet dhe ka vepruar në kundërshtim me ligjin të drejtohen tek Departamenti për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde profesionale pranë MPB-së por edhe tek Avokati i Popullit, që ka për obligim ligjor të bëjë kontrollin e punës së policisë.

C) REKOMANDIME për pjesëtarët e MPB-së

- » Policia duhet të ketë qasje edukative, të bashkëpunojë me gazetarët dhe reporterët në ngjarje me rrezik të lartë dhe t'i udhëzojë për mënyrat e mbrojtjes, të mbrojtë ata dhe të sigurojë kushte për raportim të papenguar.
- » Vazhdimisht duhet të punohet për edukimin e nëpunësve policor si në mënyrë profesionale të sigurojnë hapësirën nga e cila gazetarët në gjendje të sigurt do të raportojnë, veçanërisht kur bëhet fjalë për ngjarje me rrezik të lartë.

Ç) REKOMANDIME për PP-në

- » Prokuroria Publike të veprojë në përputhje me kompetencat ligjore dhe Kodin e Etikës së Prokurorisë Publike, t'ju mundësojë gazetarëve të plotësojnë detyrën e tyre – informimin e publikut, gjatë raportimit nga ndonjë ngjarje me të cilin udhëheq prokuror përgjegjës.
- » Prokuroria Publike të rrit transparencën si institucion dhe t'ju mundësojë gazetarëve qasje në informacione të rëndësishme për publikun duke organizuar njoftime javore dhe ngjashëm.

- » Të organizojë aktivitete të përbashkëta për ngritjen e nivelit të profesionalizmit të gjitha profesioneve (gazetarë dhe nëpunës policor, prokurorë), si dhe ngritje të vetëdijes së publikut për rëndësinë e tyre.
- » Më e rëndësishme është të ketë komunikim të hapur mes gazetarëve, policisë dhe prokurorisë, pa ndonjë frikë dhe në frymën e bashkëpunimit.

SË SHPEJTI LINJË TELEFONIKE FALAS PËR RAPORTIMIN E SULMEVE NDAJ GAZETARËVE

Në përpjekje për të përmirësuar sigurinë e gazetarëve, Misioni i OSBE-së në Shkup në bashkëpunim me Sindikatën e Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias (SPGPM) ka hapur linjë telefonike për të ofruar ndihmë dhe mbështetje për gazetarët dhe punëtorët e medias në rast të kërcënimeve, sulmeve verbale ose fizike, ngacmimeve në internet, dhunës me bazë gjinore, shantazheve, shkatërrimit të pronës personale ose profesionale, si dhe bastisjes në redaksitë dhe shtëpitë e gazetarëve.

Operatori i trajnuar i linjës telefonike do të këshillojë gazetarët dhe punëtorët e medias se si të veprojnë në situata të caktuara dhe do t'i informojë ata lidhur me mekanizmat në dispozicion për parashtrimin e ankesave. Operatori telefonik poashtu do të ruajë një regjistër të rasteve të cilat pritet të trajtohen nga institucionet përkatëse, si dhe do të përgatit një raport për secilin rast. Raportet do t'i dorëzohen Misionit të OSBE-së në Shkup dhe Zyrës së Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias.

Vëmendje e veçantë dhe këshilla do t'iu ofrohen gazetarëve femra, posaçërisht lidhur me kërcënimet në internet dhe shantazhet.

Linja telefonike falas pritet të jetë aktive nga fundi i vitit 2018.

PJESA IV

INFORMACIONE
PLOTËSUESE

BURIME PLOTËSUESE PËR SIGURI TË GAZETARËVE, FOTOREPORTERËVE DHE PUNONJËSVE TË MEDIAS

- Platforma për Promovim dhe Mbrojtje të Gazetarisë dhe Sigurisë së Gazetarëve (Këshilli i Evropës)
<https://www.coe.int/en/web/media-freedom>
- Udhëzuesi i Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (FNM)
<http://ifj-safety.org/assets/docs/130/107/d325b82-b1d816b.pdf>
- Udhëzuesi për Siguri të Gazetarëve (OSBE)
<https://www.osce.org/fom/118052>
- Udhëzime për Foto raportim të Sigurt dhe Etikë (SHGM)
znm.org.mk/wp-content/uploads/2016/03/Упатство-за-безбедно-фото-репортерство-и-етика-2016.pdf
- Udhëzues për Siguri të Gazetarëve (UNESCO dhe GPK)
https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/guide_journaliste_rsf_2015_en.pdf
- Udhëzues për Gazetarë gjatë Kohës së Zgjedhjeve (GPK dhe Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë)
https://issuu.com/rsf_webmaster/docs/guide_oif_anglais__web
- Udhëzues për Siguri të Gazetarëve (Shërbimi Publik i Britanisë së Madhe)
http://downloads.bbc.co.uk/mundo/pdf/safety-journalism_safety_guide_second_edition-v1.pdf
- Udhëzues për Siguri të Gazetarëve (Komiteti për Mbrojtje të Gazetarëve)
<https://cpj.org/security/guide.pdf>
- Udhëzues i Organizatës Britanike për të Drejta të Njeriut „Neni 19“ (Article 19)
<https://www.article19.org/wp-content/uploads/2017/09/Safety-of-Journalists-guide.pdf>

SHKURTESAT

KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
 GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg
 FEG – Federata Evropiane e Gazetarëve
 SHGM – Shoqata e Gazetarëve
 KMG - Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve
 MPB - Ministria e Punëve të Brendshme
 ONG – Organizata Ndërkombëtare e Gazetarëve
 OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
 PP - Prokuroria Publike
 GPK – Gazetarë pa Kufij
 KE – Këshilli i Evropës
 OMEJL – Organizata e Mediave të Evropës Juglindore
 LPP – Ligji për Procedurë Penale